



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Nr. 579 prot.

Tiranë, më 30/01/2023

**Deklaratë për emërtimin e Autoritetit Certifikues të certifikatave elektronike të gjeneruara nga PKI (Public Key Infrastructure)**

Kjo deklaratë hartohet në kuadër të kërkesave të përcaktuara për certifikimin eIDAS për shërbimet e besuara.

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, ligjit nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar, Vendimin nr.495, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të shërbimeve publike elektronike” si dhe Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, AKSHI zhvillon, administron dhe mirëmban infrastrukturën e çelësit publik dhe menaxhon certifikatat e kualifikuara të Nënshkrimit Elektronik dhe Vulës Elektronike për administratën publike.

Në profilet e të gjitha certifikatave elektronike të gjeneruara nga AKSHI është shënuar si Autoritet Certifikues i certifikatave emërtimi “NAIS” që korrespondon me emërtimin në anglisht të AKSHI-t.

Deklarojmë se të gjitha certifikatat elektronike që kanë në emërtimin "Issued by" të shënuar termin "NAIS" si Autoritet Certifikues, janë certifikata elektronike të gjeneruara nga institucioni i AKSHI-t.

Akronimi në gjuhën angleze për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit është National Agency of Information Society ( NAIS).

**Miratoi:**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Mirlinda KARÇANAJ**

